



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7/2024 (JR)  
Nr. 7/ 2 regj.

Tiranë më 19.06.2024

SHPALLJE  
E  
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e enjte, datë 18.07.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 7/2024, datë 16.02.2024, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj kundër vendimit nr. 728, datë 28.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e trupit gjykues**  
**Relatore e çështjes**  
**Anëtare**  
**Anëtare**  
**Anëtar**

**Ina Rama**  
**Mimoza Tasi**  
**Albana Shtylla**  
**Rezarta Schuetz**  
**Sokol Çomo**

Bazuar në nenin 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**

**INA RAMA**

